

demos  ti

Nr 12; 18.10.2016


SHTETI YNË



DEMOKRATIK

QEVERISJA E POPULLIT

ERTI (10), JONI (10), ERA (10), ENDRITI (10), GENÇ (10), VESA (10)



Çka na mëson demokracia?

Demokracia është qeverisje e popullit. Populli qeverisë duke votuar. Populli ka të drejta në demokraci. Në si qytetarë demokratik, nuk kemi dallime gjinore, fetare, racore, etj. Nëse ne e takojmë një person të një besimi dhe race tjetër, duhet ta respektojmë dhe të mos e diskriminojmë atë. Disa nga liritë dhe të drejtat, që ne në demokraci i kemi janë: liria e shkollimit, e drejta e punësimit, e drejta e lojës, e drejta e strehimit, e drejta e ushqimit, etj. P.sh. ne si nxënës kemi të drejtë ta zgjedhim profesionin tonë për të ardhmen.

Dhuna nuk ka vend në demokraci. E kundërta e dhunës është paqja, pra në demokraci një ndër elementet kryesore është paqja.

Kosova sot është shtet i pavarur dhe demokratik. Demokracia lindi në kryeqytetin e Greqisë, Athinë . Demokracia në atë kohë ka qenë më ndryshe nga demokracia e sotme. Kjo ka ndodhur për shkak se vetëm burrat kanë marrë pjesë në mbledhje të shtetit. Sot në demokraci janë të drejtat e barabarta mes grave dhe burrave. Fjala demokraci rrjedh nga fjala greke „demo“ që do të thotë popull dhe „kratia“ qeverisje. Në demokraci populli qeverisë përmes votës.

ZGJEDHJET

Të marrësh pjesë në procesin e zgjedhjeve duhet të jesh mbi moshën 18 vjeçare. Votat duhet të jenë të fshehta dhe duhet të jenë mendimi ynë pavarësisht të

tjerëve. Kur ne të mbushim moshën 18 vjeçare, do të kemi të drejtë të marrim pjesë në votime. Pra, vota jonë do të bëjë një ndryshim të madh në demokraci.



Gazetarët duke punuar



Autorët e artikullit

KUVENDI NË DEMOKRACI

ERNA (10), ANISA (10), ROBERT (10). ENESA (10), ORES (10), VALTONI (10)

Çka mësuam ne për Kuvendin?

Kuvendi është vendi ku merren vendimet për popullin. Në demokracinë parlamentare, populli zgjedh përfaqësuesit e vet. Përfaqësuesit e popullit janë deputetët. Mbledhja e deputetëve në Kuvend quhet seancë plenare.

Në Kuvend miratohen ligjet. Propozimet e ligjeve i bënë Qeveria, Kuvendi, mbi 10.000 qytetarë dhe Presidenti. Propozimet në Kuvend kontrollohen nga grupet punuese me deputetët, që quhen komisione parlamentare. Për shembull, komisioni për arsim, komisioni për shëndetësi, komisioni për të drejtat e njeriut, komisioni për bujqësi, etj.



Gazetarët e artikullit

Secili fëmijë ka të drejtë për arsimim.



Komisioni për Arsim

Të gjithë kanë të drejta të barabarta për kujdesin shëndetësor.



Komisioni për Shëndetësi

Në ligjin për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, hyn e drejta e shprehjes.



Komisioni për të Drejtat e Njeriut



Kuvendi

QYTETARËT NË DEMOKRACI


ALDIN (10), GENT (10), ZOJA (10), ERISA (10), GETUARI (10), DIART (10)

Ta mbrojmë AMBIENTIN

T'i kryejmë përgjegjësitë tona si qytetarë që jemi

Ne të gjithë jemi qytetarë. Qytetar do të thotë të jesh i sjellshëm, të kesh kulturë dhe të sillësh me edukatë. Një qytetar i mirë i respekton rregullat dhe ligjet. Secili qytetar i rregullt duhet të ketë: sjellje në nivel të kënaqshëm, të mos hedh mbeturina, të mos bëjë krime dhe të respektojë të tjerët.

Qytetari ka të drejta dhe përgjegjësi. Disa nga të drejtat e qytetarëve janë: e drejta e shkollimit, e drejta për të organizuar dhe marrë pjesë në protesta paqësore, e drejta e punësimit pas moshës 18 vjeçare, e drejta për martesë, e drejta e vozitjes së makinës mbi 18 vjeç, etj. Ndërsa disa nga përgjegjësitë që ne në këtë moshë i kemi janë: të pastrojmë klasën, të mbrojmë ambientin, të respektojmë të tjerët, etj.



Respektimi i rregullave të komunikacionit



Ne jemi shembull për qytetarët e tjerë



Duke vizatuar se si duhet ta ruajmë ambientin

NDARJA E PUSHTETIT

RRON (11), LEONIT (10), ERISA (10), ENSAR (10), LISARD (11), RITA (11), ENDI (10)

Sot mësuam se Kuvendi i Kosovës është Pushteti Legjislativ, Qeveria e Kosovës është Pushteti Ekzekutiv dhe gjykatat janë Pushteti Gjyqësor


Ne me Kuvend të Kosovës kuptojmë vendin ku punojnë deputetët, të cilët janë përfaqësuesit e popullit. Deputetët votojnë ligje dhe i miratojnë ato. Në Kuvend janë 120 deputetë. 20 vende janë për deputetët, që përzgjedhen nga komunitetet jo shumicë. Kuvendi miraton ligjet, buxhetin e shtetit dhe mbikëqyr punën e Qeverisë. Në Qeveri bëjnë pjesë Kryeministri, ministrat dhe zv. ministrat. Qeveria është Pushteti Ekzekutiv. Ajo propozon buxhetin e shtetit, i zbaton ligjet, etj. Pushteti Gjyqësor është vendi ku gjykatësit marrin vendime për të dyshuarin, nese ai nuk e ka respektuar ligjin. Në Pushtetin Gjyqësor në Kosovë bëjnë pjesë tri gjykata: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.



Gazetarët e këtij artikulli




Gazetarët gjatë punës



Kuvendi i Kosovës



Qeveria e Kosovës



Gjykata e Kosovës



IMPRESUM

demos ti

Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga

TOKA

Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Faik Konica“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-3
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë